

Letërnjoftimi i Komunës së

HANITË

ELEZT

2014

Maj, 2015



Fakte


- Më 2014, të hyrat buxhetore të Komunës së Hanit të Elezit ishin afro 280 mijë euro. Pjesa më e madhe e këtyre të hyrave ishte nga tatimi në pronë. Të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë rreth 33% të të hyrave të përgjithshme.
- Sa i përket shpenzimeve për dreka zyrtare, telefona mobil, telefona fiks, shpenzime për mëditje jashtë vendit, riparimi i veturave, kanë shënuar rënie në krahasim me një vit më parë.
- Komuna e Hanit të Elezit nuk ka persona të punësuar me kontratë mbi vepër.
- Hani i Elezit ka të punësuar një shërbyes civil për 200 banorë. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.
- Në vitin 2014, Komuna e Hanit të Elezit ka zvogëluar numrin e të punësuarve në sektorin publik, nga 209 që ishin të punësuar në vitin 2013, në 201 të punësuar.
- Në sektorin e arsimit janë të punësuar 118 persona, prej tyre 104 mësimdhënës.
- Në Komunën e Hanit të Elezit raporti nxënës/mësimdhënës është 38.4. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9.
- Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 36 punonjës. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Hanit të Elezit është 274.7. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.
- Hani i Elezit gjatë vitit 2014 ka pasur 258 persona nën skemën sociale. Krahasuar me numrin total të popullsisë në këtë komunë del se në Hanin e Elezit rreth 2.7% e popullsisë të ardhurat i bazojnë në skemat sociale.
- Në Komunën e Hanit të Elezit funksionojnë 118 biznese.
- Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 26 biznese të reja. Ndërsa janë shuar vetëm 2 biznese tregtare.
- Kryetari i Hanit të Elezit z. Rufki Suma gjatë fushatës zgjedhore ka dhënë 15 premtime nga fusha të ndryshme. Deri në maj 2015, shkalla e realizueshmërisë së premtimeve është 33%, apo mbi mesatare në shkallë vendi, e cila është 24%.

2 Qeverisja komunale

Qytetarët e Komunës së Hanit të Elezit në zgjedhjet e fundit lokale (2013) ia besuan votën për të dytën herë kandidatit të pavarur z. Rufki Suma.


Në zgjedhje kanë votuar gjithsej 5,259 apo rreth 62% qytetarë me të drejtë vote. Kryetari aktual i Hanit të Elezit z.Rufki Suma ka marrë 2,864 vota apo 54.74 % të votave, ndërsa kandidati i tjetër z. Mehmet Ballazhi (PDK) ka marrë gjithsej 2,010 vota apo 38.42 %.

Grafikoni nr.1 Dallimi në vota mes dy kandidatëve për kryetar



Zgjedhjet për Kuvendi Komunal kanë nxjerr këtë përbërje: PDK 5 ulëse, AAK- LDD 4 ulëse, LDK dhe Vetëvendosje me nga 3 ulëse.


Grafikoni nr.2 Ndarja e ulëseve sipas partive në Kuvendin Komunal të Hanit të Elezit në bazë të zgjedhjeve 2013



3 Buxheti i Komunës së Hanit të Elezit

Më 2014, Komuna e Hanit të Elezit kishte buxhet prej 1,8 milion eurove, një rritje prej afro gjysmë milion eurosh në krahasim me vitin 2013. Pjesa më e madhe e këtij buxheti shpenzohet për paga dhe mëditje për 201 të punësuarit në arsim, shëndetësi dhe administratë. Buxheti për investime kapitale është 420 mijë euro, një rënie e lehtë në krahasim me vitin paraprak.


Grafikoni nr. 3 Buxheti total i Komunës së Hanit të Elezit dhe kategoritë kryesore buxhetore



Instituti GAP

Më 2014, të hyrat buxhetore të Komunës së Hanit të Elezit ishin afro 280 mijë euro. Të hyrat vetanake kanë shënuar rritje të konsiderueshme në krahasim me vitin 2013.


Grafikoni nr.4 Trendi i të hyrave vetanake të Komunës së Hanit të Elezit 2011-2015



Instituti GAP


Pjesa më e madhe e këtyre të hyrave ishte nga tatimi në pronë. Të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë rreth 33% të të hyrave të përgjithshme.

Grafikoni nr.5 Kategoritë e të hyrave buxhetore




Në krahasim me komunitat tjera të cilat kanë numër të përafërt të popullsisë dhe territorit, Komuna e Hanit të Elezit nuk ka ndonjë përjashtim sa i përket mbledhjes së të hyrave.

Grafikoni nr.6 Krahasimi i komunave për nga të hyrat nga tatimi në pronë



Sa i përket shpenzimeve për dreka zyrtare, telefona mobil, telefona fiks, shpenzime për mëditje jashtë vendit, riparimi i veturave, kanë shënuar rënie në krahasim me një vit më parë, ashtu siç mund të shihet nga grafikoni numër 7.


Grafikoni nr. 7 Shpenzimet për disa kategori buxhetore



Instituti GAP

Komuna e Hanit të Elezit gjatë vitit 2014 ka shpenzuar për energji elektrike 28 mijë euro, ndërsa për mbeturina rreth 6,600 euro. Në të dy këto kategori ka pasur një rritje të lehtë krahasuar me një vit më parë.


Grafikoni nr. 8 Shpenzimet komunale sipas kategorive dhe viteve



4 Të punësuarit në sektorin publik


Vitin 2014 Hani i Elezit ka përmbyllur me 201 të punësuar në sektorin publik, pesë më pak se sa një vit më parë, apo tre shërbyes civil më pak në kuadër të administratës dhe dy punonjës më pak në sektorin e arsimit.

Grafikoni nr.9 Numri i të punësuarve në sektorin publik në Komunën e Hanit të Elezit



Hani i Elezit ka të punësuar një shërbyes civil për 200 banorë. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.

Grafikoni nr.10 Raporti të punësuar në administratë për kokë banori




Përveç të punësuarve me kontrata të rregullta, në shumicën e komunave të Kosovës ka edhe persona të punësuar me kontratë mbi vepër. Ndërsa Komuna e Hanit të Elezit nuk ka persona të tillë të punësuar.

Grafikoni nr.11 Të punësuar me kontratë mbi vepër




Në sektorin e arsimit janë të punësuar 118 persona, prej tyre 104 mësime dhënë. Në Komunën e Hanit të Elezit raporti nxënës/mësime dhënë është 38.4. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9.

Grafikoni nr.12 Raporti nxënës/mësime dhënë në Komunën e Hanit të Elezit



Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 36 punonjës. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Hanit të Elezit është 274.7. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.


Grafikoni nr.13 Punonjës shëndetësor për kokë banori



5 Ekonomia lokale

Në Komunën e Hanit të Elezit funksionojnë 118 biznese. Pjesa më e madhe e bizneseve të regjistruara më 2014 janë biznese me fushë veprimtari tregtare. Në të njëjtën periudhë, janë shuar vetëm 2 biznese tregtare.


Grafikoni nr.14 Llojet e bizneseve të reja të regjistruara më 2014



6 Premtimet

Instituti GAP ka monitoruar premtimet e dhëna nga z. Rufki Suma gjatë fushatës zgjedhore 2013. Nga 15 premtimet e monitoruara, del se deri në maj 2015 z. Suma ka arritur të realizoj 33% te premtimeve. Mesatarja e premtimeve të realizuara për të gjitha komunat e Kosovës deri në maj 2015 është 24%.

Grafikoni nr.15 Premtimet e Kryetari dhe shkalla e realizimit





Instituti GAP

Rr.Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Kati 2
+381 38 609 339

info@institutigap.org
www.institutigap.org
www.komunat.institutigap.org

